

## **Projektakte të tjera në proces**

- Projektvendimi “Kriteret dhe procedurat për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, përcakton kriteret sipas llojit të fatkeqësisë.
- Projektvendimi “Përbërja e pozicioneve të punës dhe detyrat deri në nivel sektori për mbrojtjen civile në çdo ministri”, përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e sektorëve në institucionet qendrore për mbrojtjen civile.
- Projektvendimi “Kriteret dhe procedurat e akordimit të fondeve për marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në infrastrukturën e dëmtuar, si dhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile”, përcakton kriteret dhe procedurat për akordimin e fondeve që lidhen me marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, si dhe veprimtari të tjera në fushën e mbrojtjes civile.
- Projektvendimi “Miratimi i flamurit, stemës dhe uniformës së AKMC”.
- Projektvendimi “Për vërtetimin mbi riskun”, përcakton kriteret dhe autoritetet që japin vërtetimin mbi riskun.